





**TRAJNIMI "SHKOLLA PËR TË DREJTA TË NJERIUT"**

**14.05**


Në kuadër të projektit "Programi edukativ i të drejtave të njeriut - Të drejtat e njeriut në horizont", u mbajt një ligjeratë për pjesëmarrësit e Shkollës për të Drejtat e Njeriut. Ligjerata u mbajt nga Z. Milosh Hërnjaz, profesor asistent në fushën e së drejtës ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd. Z. Hërnjaz prezantoi pjesëmarrësve në shkollë me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe konceptin e përgjithshëm të të drejtave të njeriut.



Projekti "Shkollat e të Drejtave të Njeriut" financohet nga CDF si pjesë e projektit "Programi i Edukimit për të Drejtat e Njeriut - Të Drejtat e Njeriut në Horizont".

**HAPJA E PROJEKTIT "FUQIZIMI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE PRONËSORE NË KOSOVË"**

**18.05**



Qendra për Dialog Social dhe Nismat Rajonale (CSDRI) dhe Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) kanë prezantuar zyrtarisht projektin "Fuqizimi i Mekanizmave të të Drejtave të Pronës në Kosovë". Projekti u prezantua nga Z. Dushan Milenković, President i Bordit Menaxhues të CSDRI, Z. Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i ACDC dhe Z. Aca Mitiq, Drejtor i Programit ACDC.

Gjatë prezantimit një orësh, ata prezantuan qëllimet, rezultatet dhe aktivitetet e projektit që do të zbatohen në gjashtë muajt e ardhshëm. Projekti mbështetet nga Fondi Ballkanik për Demokraci (BTD).

**SIMULIMI I GJYKIMIT BRENDA PROJEKTIT "RRITJA E TRANSPARENCËS DHE SUNDIMIT TË LIGJIT NË KOMUNITETET ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË"**

**21.05**

Në ambientet e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dhjetë praktikantë të angazhuar në projektin "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë", financuar nga INL, realizuan përgatitjet për një simulim të gjyqimit, i cili do të zhvillohet në fund të qershorit 2021.



Praktikantëve iu dha një rast i vërtetë, një atentat, me të cilin do të duhet të përballen. Ata ndanë rolet e gjyqtarëve, avokatëve, dëshmitarëve dhe palëve të akuzuara. Ata e kanë pranuar këtë sfidë dhe shpresojmë që ta zgjidhin me sukses rastin e dhënë.





Në ambientet e Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike, u prezantua projekti "Gratë Sipërmarrëse në Energji". Përfaqësuesit e HELP-it, të cilët po zbatojnë këtë projekt gjithashtu zhvilluan një takim me gratë e interesuara në këtë fushë. Projekti "Gratë Sipërmarrëse në Energji" u iniciua dhe u mbështet nga Millennium Foundation Kosovo.



DISKTUIMET PUBLIKE

Më 26 maj, OJQ Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike organizoi një diskutim publik mbi "Delikuencën e të Miturve në veri të Kosovës gjatë pandemisë COVID 19". Panelistët në konferencë ishin znj. Biljana Jarediq, psikologe, profesoreshë në Universitetin e Prishtinës me seli të përkohshme në Mitrovicë, znj. Millena Miliq, specialiste e rehabilitimit social, Qendra për punë sociale dhe z. Jugoslav Bogavac, mbikëqyrës i departamentit për Hetimi i Dhunës në Familje dhe Delikuencës së të Miturve. Panelistët prezantuan problemin e delikuencës së të miturve, disa nga arsyet pse ndodh, dhe gjithashtu mënyrat për të parandaluar delikuencën.



Në konferencë morën pjesë avokatë, aktivistë të shoqërisë civile, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe mediave, si dhe të tjerë.

Diskusimi publik u mbajt si pjesë e projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë", financuar nga INL Kosova.



TRAJNIMI "SHKOLLA PËR TË DREJTA TË NJERIUT"

Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike organizoi një modul të ri ligjerate në Shkollën e të Drejtave të Njeriut. Moduli i tretë me temën "Parimet e Barazisë dhe Mos-Diskriminimit" u mbajt nga Znj. Marija Raduloviq, Zëvendëse e Avokatit të Popullit. Znj. Raduloviq foli për barazinë, mosdiskriminimin, format e diskriminimit, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, urdhërin për diskriminim dhe viktimizimin.

Projekti "Shkollat e të Drejtave të Njeriut" financohet nga CDF si pjesë e projektit "Programi i Edukimit për të Drejtat e Njeriut - Të Drejtat e Njeriut në Horizont".